



Republika e Sërbisë Trupi Koordinues për komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë

Informatat rreth aktiviteteve të Trupit Koordinues

(mars-tetorë 2009)

Trupi koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë prezenton raportin e aktiviteteve të sajë në periudhën mars-tetorë 2009. Dy ngjarje shumë të rëndësishme që kanë shënuar këtë periudhë janë:



- Nënshkrimi i Marrëveshjes e principeve të rekonstruimit të Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë sipas së cilës përfaqësuesit politik shqipëtarë prap janë kyqur në punën e Trupit Koordinues.



- Hapja e paraleleve të fakultetit Juridik dhe Ekonomik të univerzitetit të Nishit në Medvegjë Trupi koordinues në periudhën e kaluar ka arritur suksese të rëndësishme në krahasim me prioritetet e sajë të definuara. Shkurtimisht:

a) Në sferën politike – Përfaqësuesit e partive politike Shqipëtare janë kyqur në punën e Trupit Koordinues. Është nënshkruar Marrëveshja e principeve të rekonstruimit të Trupit Koordinues dhe Vendimi mbi reorganizimin e Trupit Koordinues sipas së cilit do të përmirësohej efikasiteti në punën e tij.

b) Në sferën e ekonomisë – Trupit Koordinues në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me ministrinë tjera relevante të Qeverisë së Republikës së Serbisë deri në tetorë të vitit 2009 ka investuar mbi **250 milionë dinarë** në përmirësimin e infrastrukturës që të përforcohet ekonomia e këtyre komunave. Trupi Koordinues vazhdon të punojë në kyqjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore.

v) Në sferën e integriteteve – Trupi Koordinues në bashkëpunim me ministrinë e arsimit dhe nën mbështetjen financiare të Agjencionit Amerikan për zhvillim ndërkombëtarë (USAID) ka krijuar kushtet që studentët nga Serbia jugore të studjojnë në gjuhën e tyre amtare. Hapja e shkollave të larta në Medvegjë me mësim në gjuhën serbe dhe shqipe është një ndër kushtet e rëndësishme për integrimin e Shqipëtarëve në rrjedhat shoqërore të Republikës së Serbisë. Përpos kësaj, Trupi Koordinues deri në tetorë të vitit 2009 ka investuar **14 milionë dinarë** për rininë dhe projektet rinore, shoqërinë civile si dhe ndihma sociale për kategoritë më të rrezikuara.

g) Në raportet ndërkombëtare – Me komunikimin të vazhdueshëm sipas principit „Dyert e hapura” sipas së cilës Shërbimi i Trupit Koordinues dhe kryetari i saj Milan Marković gjithmonë janë në dispozicion partnerëve të tyre ndërkombëtarë si dhe kanë bashkëpunimi të shkëlqyeshëm në përmirësimin e kushteve jetësore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

d) Në komunikimin publik – Shërbimi i Trupit Koordinues për punën e tij vazhdon në mënyrë kontinuele të raportojë mediat, Qeverinë e Republikës së Serbisë, partnerët ndërkombëtarë dhe të tjerë si dhe lajmëron qytetarët e interesuar përmes webfaqes e saj.

Trupi Koordinues përpiqet t'i përmirësojë problemet dhe prioritetet, dhe se në periudhën e ardhshme do të fokusohet në këto aktivitete:

a) Në sferën politike – Formimi i pushtetit multi-etnik në Preshevë dhe Bujanoc dhe kyqja e Shqipëtarëve në institucionet shtetërore siq edhe është definuar me Marrëveshjen e principeve të rekonstruimit të Trupit Koordinues.

b) Në sferën e integritimeve – Përfundimi i Studios së Fizibilitetit për hapjen e shkollave të larta në Bujanoc dhe Preshevë me mësim në gjuhën sSerbe dhe Shqipe.

Aktivitetet kryesore të Trupit Koordinues në periudhën e kaluar:

- **Përfaqësuesit e shqipëtarëve përsëri në Trupin Koordinues** – Kryetari i Trupit Koordinues së Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje njëherit edhe kryetarë i pushtetit lokal Milan Marković, deputeti popullorë në Kuvendin e Republikës së Serbisë, Riza Halimi dhe ish kryeshefi i



OSBE-së në Serbi Hans Ola Urstad, kanë nënshkruar më 27 mars Marrëveshjen e mbi principet e rekonstruimit të Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. Kryetari i trupit Koordinues, Milan Marković, deputeti popullorë, Riza Halimi,, kryetarët e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes, kryetari i Kuvendit komunal të Bujanocit dhe drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues kanë nënshkruar Vendimin për reorganizimin dhe kompetencat e Trupit Koordinues. Gjatë nënshkrimit të këtij Vendimi morën pjesë ish ambasadori i SHBA-së si edhe përfaqësuesit e ambasadës së SHBA-ve dhe ambasadës Britanike në Beograd, pastaj sekretari shtetërorë pran Ministrisë së Drejtësisë Slobodan Homen, ombudsmani republikan Sasha

Janković, nënkryetarët e Trupit Koordinues Dusha Spasojeviq, Dejan Jovanović dhe Sima Gazikalović. Teksti i Marrëveshjes dhe Vendimi i reorganizimit dhe kompetencat e Trupit Koordinues gjendet në webfaqen e Trupit Koordinues www.kt.gov.rs.

- **Janë mbajtur katër takime të Kryesisë së Trupit Koordinues** – Që nga nënshkrimi i marrëveshjes për kyqjen e përfaqësuesve Shqipëtarë, janë mbajtur katër takime të Kryesisë së Trupit koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje prej të cilave tri në beograd (prill, shtatorë dhe tetorë) dhe një në Bujanoc (në maj). Të gjitha takimet janë udhëhequr nga kryetari i Trupit Koordinues Milan Marković dhe zëvendësi i tijë Shaip Kamberi, kryetarë i komunës së Bujanocit. Në përbërjen e ngushtë të Trupit Koordinues bëjnë pjesë edhe Riza Halimi, deputet popullorë, nënkryetarët e Trupit Koordinues Dejan Jovanović, Dusha Spasojeviq dhe Sima Gazikalović, kryetarët e komunave të Preshevës dhe Medvegjes, Ragmi Mustafa dhe Slobodan Drashković, kryetarët e Kuvendeve komunale si dhe drejtori i Shërbimit të Trupit koordinues, Nenad Gjurgjeviq. Në takimin e parë të Kryesisë është aprovuar Rregullorja mbi punën e Trupit Koordinues si dhe janë formuar gjashtë Grupe punuese: 1) Grupi punues për ekonomi dhe zhvillim infrastrukturorë; 2) për integritime shoqëro-politike; 3) për siguri dhe drejtësi; 4) përforcimi i kapaciteteve të pushteteve lokale dhe aftësimin e saj për vetëmbajtje; 5) për arsim, kulturë, informim, sport dhe rini dhe 6) për shëndetësi dhe politikë sociale. Grupi punues për arsim, kulturë, informim, sport dhe rini është formuar në prill të vitit 2009 dhe deri më tash janë takuar katër herë. Në takimin e kryesisë të mbajtur më 19 tetorë rënë dakord për formimin edhe të grupeve tjera punuese deri në tetorë të vitit 2009.

- **158 milion dinarë nga Trupi Koordinues për projekte infrastrukturore** – Deri në tetorë të vitit 2009, Qeveria e Republikës së Serbisë përmes Trupit Koordinues ka investuar afër 158 milion dinarë për projekte infrastrukturore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (rrugë, shkolla, rrjetin elektrik dhe tjera). Deri në fund të vitit, Trupi Koordinues do të financojë projekte tjera që kapin sumën 68 milion dinarë. Në Preshevë deri më tash janë finansuar 14 projekte me 61 milion dinarë. Në Bujanoc janë finansuar 7 projekte me 59 milion dinarë kurse në Medvegjë janë finansuar 10 projekte me 38 milion dinarë.



- **76 milion dinarë nga Ministria për NIP** – Në bashkëpunim me Trupin Koordinues, Ministria për NIP në suaza të programit për infrastrukturë në 40 komuna më të pazhvilluara në Republikën e Serbisë, ka ndarë 76 milion dinarë për projektet në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për vitin 2009. Komunës së Bujanocit u janë ndarë 34 milion dinarë për vazhdimin e ndërtimit të shkollës së mesme „Sezai Surroi”. Bujanoci ka fituar edhe 10 milion dinarë shtesë për si stimulim për punë të mirë në bazë të kriteriumeve të cilat i ka vënë Ministria e NIP-it. Medvegja ka marrë 5 milion dinarë për rekonstruimin e pjesës së rrugës Jablanica kurse Preshevës u janë lejuar 27 milion dinarë për projektin e rrjetit të rrymës në „Stacionin hekurudhorë” në Preshevë.

- **Kanë filluar punët në rekonstruimin e qendrës së qytetit në Preshevë dhe elektrifikimi i një pjese të Bujanocit** – Kryetari i Trupit Koordinues, Milan Marković më 1 shtatorë me kryetarin e Preshevës Ragmi Mustafën, kanë hapur punën në rekonstruimin e qendrës së qytetit. Po të njejtën ditë në Bujanoc, Milan Marković së bashku me kryetarin e komunës së Bujanocit, Šaip Kamberin, në Bujanoc kanë hapur punën në elektrifikimin e pjesës së qytetit. „Kjo ka rëndësi të dyfishtë, njëra është rëndësia industriale sepse këtu planifikohet të jetë zonë industriale kurse rëndësia tjetër është siguria e rrymës elektrike për romët e kësaj pjese të qytetit”, deklaroi Marković.

- **Vazhdon bashkëpunimi në mes të Trupit Koordinues dhe Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave** – Në mars të këtij viti Ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave Sasha Dragin dhe Drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues Nenad Gjurgjević kanë dorëzuar fidane, komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Janë dorëzuar 11 tonelatë elb, 6 tonelatë tërshërë dhe më tepër se 1 tonelatë misër. Gjithashtu janë donuar 10.000 fidane të hardhisë së rrushit, 1.400 fidane të pemëve (mollë, dardhë, vishnje, qersh, kumbulla, malina) dhe 210 pakete farash të perimeve të ndryshme.



- **Është hapur fakulteti në Medvegjë** – Më 12 tetorë të vitit 2009, kryeministri i Qeverisë së Republikës së Serbisë, Mirko Cvetković në Medvegjë solemnisht hapi paralelet e fakultetit Ekonomik dhe Juridik të Univerzitetit të Nishit. Me atë rast, kryetari Trupit Koordinues Milan Marković dhe ministri i arsimit Zharko Obradović kanë shpërndarë indeksat gjeneratës së parë të studentëve. Në këtë ceremonial morën pjesë zëvendësambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Troy Peterson dhe kryeshefi i misionit të OSBE-së në Serbi Dimitrios Kipreos. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si dhe përfaqësues të pushteteve lokale dhe shoqërive civile nga regjioni i Pčinjës dhe Jabllanicës. Hapja e fakultetit në Medvegjë është një prioritet strategjik i Trupit Koordinues dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë. Qëllimi i këtij projekti është përforsimi i të gjitha bashkësive etnike si dhe arsimit kualitativ në gjuhën Serbe dhe Shqipe. Ligjëratat në fakultetin Ekonomik dhe Juridik të univerzitetit të Nishit do të organizohet për studentët në gjuhën e tyre amtare, Shqipe dhe Serbe. Iniciativën e trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ka përkrahur Ministria e arsimit e cila ka pasur ndikim të konsiderueshëm në hapjen e këtij fakulteti. Hapjen e fakultetit në Medvegjë finansiarisht ka ndihmuar Agjensioni Amerikan për zhvillim ndërkombëtarë (USAID-i) kurse projektin e ka përkrahur edhe Misioni për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) në Serbi.

- **Janë ndarë mjete në konkurset e Trupit Koordinues** – Komisioni i Shërbimit të Trupit Koordinues ka marrë vendim për finansimin e projekteve në konkursin për realizimin e projekteve të shoqatave të qytetarëve në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës për vitin 2009 si në finansimin e projekteve në kuadër të Programit mbi shpërndarjen (apo ndarjen, distribumin, dedikimin) dhe shfrytëzimin e mjeteve për programet që përkojnë me realizimin dhe avansimin e të drejtave sociale dhe veçantive (veçorive, specifikave) të pakicave, në regjionin e komunave: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, për vitin 2009. Në konkurs për finansimin e projekteve të shoqatave të qytetarëve nga të planifikuarat 3.000.000 dinarë, janë shpërndarë 2.358.748,5 dinarë. Në konkurs kanë arritur 25 kurse Shërbimi i Trupit Koordinues ka lejuar mjete për finansimin e 5 projekteve. Në konkurs për finansimin e projekteve në kuadër të Programit mbi shpërndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për programet që përkojnë me realizimin dhe avansimin e të drejtave sociale dhe veçantive të pakicave për vitin 2009 në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës nga të planifikuarat 9.000.000 dinarë, janë shpërndarë 8.696.224 dinarë. Në konkurs kanë arritur 25 kurse Shërbimi i Trupit Koordinues ka lejuar mjete për finansimin e 7 projekteve. Ranglista e këtyre projekteve të finansuara gjendet në webfaqen e Trupit Koordinues. Konkursi i ri do të shpallet deri në fundë të tetorit të vitit 2009.
- **Trupi Koordinues ka shpërndarë 152 bursa** – Në bazë të kriteriumeve të definuara në konkursin për bursat e nxënësve si dhe në bazë të buxhetit në disponim, Trupi Koordinues ka shpërndarë bursa për 152 nxënës – 58 nga Presheva, 55 nga Bujanoci dhe 39 nga Medvegja. Suma e përgjithshme e këtij donacioni për këtë vit është 3.040.000 dinarë. Bursat i kanë fituar të gjithë nxënësit që nuk kanë njërin apo të dy prindërit si dhe nxënësit me kushtë të rënda materiale, mirëpo që kanë sukses të mirë gjatë shkollimit. Gjithësej 819 nxënës të shkollave të mesme prej të cilëve 444 nga Presheva, 256 nga Bujanoci dhe 119 nga Medvegja kanë konkuruar në konkursin të cilin e ka shpallur Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë më 25 qershorë të vitit 2009. Ky është viti i parë që nga formimi i Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë që në buxhetin e saj janë shpërndarë mjete për bursa të nxënësve. Aktivitetet e tilla janë në përputhje me katër prioritetet të Trupit Koordinues: arsimit, qështjet sociale, zhvillimi ekonomik dhe forcimi i kapaciteteve të sektorit joqeveritar në këto komuna.
- **6 milion dinarë për ndihma emergjente personave me nevoja të posaqme, nënave mbajtëse të familjeve dhe fëmijëve pa prindër** – Për ndihmë emergjente për personat me nevoja të posaqme, nënave mbajtëse të familjes dhe fëmijët pa prindër, Trupi Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, deri në fundë të vitit, në gjirologaritë e këtyre tri komunave do të paguajë 6 milion dinarë. Transferi i pjesës së parë të mjeteve nga një milion dinarë për qdo komunë është realizuar në shtatorë, kurse nga një milion dinarë tjerë secila komunë do të marrë në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm. Para se të marrin mjetet, secila komunë është e obliguar të formojë komisionin për shpërndarjen e këtyre mjeteve në të cilin komision Shërbimi i Trupit Koordinues do të ketë nga një përfaqësues të tij. Trupi Koordinues ka marrë këtë aksion duke marrë parasyshë se në këtë krizë ekonomike më së tepërmi vuajnë komunat e pazhvilluara kurse pasojat së pari e ndiejnë qytetarët e varfër të këtyre komunave.
- **Trupi Koordinues ka ndarë mjete mësimore për nxënësit e klasave të para nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja** – Trupi Koordinues në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ka shpërndarë 1.300 çanta me mjete të nevojshme shkollore. Vlera e qdo paketi për nxënës kap sumën prej 2.100 dinarësh. Kryetari i Trupit koordinues, Milan Markoviq, në ditën e parë shkollore, nxënësve të klasave të para në Bujanoc dhe Preshevë u ka shpërndarë çantat me mjetet primare të nevojshme. Në Preshevë kanë marrë 600 kurse në Bujanoc 603 nxënës. Milan Markoviq këto pakete i ka shpërndarë së bashku me kryetarët e komunave të Bujanocit dhe Preshevës, Shaip Kamberin dhe Ragmi Mustafën. Markoviq ka paralajmëruar edhe angazhime tjera ndihmë nga Trupi Koordinues për nxënësit dhe shkollat. Mustafa dhe Kamberi kanë shprehë falënderimet e tyre ndaj këtij aksioni. Për 97 nxënësit të shkollës fillore „Gornja Jablanica” në Medvegjë i ka dhuruar nënkryetari i Trupit Koordinues Sima Gazikaloviq së bashku me kryetarin e komunës së Medvegjës Slobodan Drashkoviç. Për një komunë të pazhvilluar siq është Medvegja, ky është një lehtësim i rëndësishëm për qdo familje e cila ka nxënës që vijon shkollën.
- **Është mbajtur takimi me ministrin e arsimit, Zharko Obradoviq** – Më 25 shtatorë është mbajtur takimi i kryetarëve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me ministrin e arsimit Zharko Obradoviq. Takimi është inicuar nga kryetari i Trupit Koordinues Milan Markoviq me qëllim të zgjidhjes së problemeve kyçe në sferën e arsimit që i preokupon këto tri komuna. Ministri Markoviq edhe njëherë theksoi se për Trupin Koordinues, arsimit dhe investimi në rini është prioritet i Trupit Koordinues në bashkëpunim me ministrinë e arsimit si dhe me institucione tjera relevante. Ministri Obradoviq edhe një herë theksoi se kryetarët të tri komunave, ministrinë e arsimit do ta kenë partnerë i cili së bashku do t'i zgjidhë të gjitha problemet në mënyrë efikase dhe konstruktive. Kryetarët e tri komunave shprehën kënaqësinë për takimin e tyre me ministrin e arsimit. Ata e informuan ministrin Obradoviq me problemet kryesore nga sfera e arsimit. Në takim u mor vesh që të gjitha problemet të zgjidhen me marrëveshje dhe se bashkëpunimi do të jetë intenziv deri në zgjidhjen e të gjitha problemeve.

- **Kompjuterë për shkollën në Bujanoc dhe fakultetin në Medvegjë** – Në suaza të aksionit „Një mijë kompjuterë për shkollat në Serbi”, Kryetari i Trupit Koordinues për Serbinë jugore, Milan Markoviq dhe drejtori i JP PTT „Srbija” Goran Qiriq më 18 shtatorë të këtij viti, shkollës fillore „Bora Stankoviq” në fshatin Klenik të komunës së Bujanocit u kanë dorëzuar 7 kompjuterë dhe dy printerë për kabinetin e informatikës. Ministri Markoviq i shprehu falënderime PTT „Srbija” për këtë donacion. Ministri Markoviq u premtoi mësimdhënësve të kësaj shkolle në zgjidhjen e problemit të rrugës që shpie në drejtim të shkollës dhe se së shpejti do të fillojë puna e asfaltimit të rrugëve lokale nëpër venbanimet përreth. Drejtori i PTT „Srbija” Qiriq, theksoi se një ndër problemet e shumta në Serbinë jugore është edhe prapambetja teknologjike duke shtuar se ky donacion do të jetë „një dritare në këtë botë” dhe mënyrë që fëmijët të njihen me popujt tjerë, kulturat e tyre dhe me njohuri të reja. Përpos kësaj, nën iniciativën e Trupit Koordinues, Direkcioni për rezerva ka dhuruar 15 kompjuterë, kurse ministria për administratë shtetërore dhe vetëqeverisje lokale ka dhuruar 4 kompjuterë për studentët e fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Medvegjë.
- **„Kolo” në Bujanoc dhe Medvegjë** – Me ndërmjetësimin e Trupit Koordinues, e në suaza të projektit „Serbia në Serbi”, qëllimi i së cilit është zhvillimi permamemt i kulturës në teritorin e tërë Serbisë, apo afrimi i programeve me vlerë artistike të gjithë qytetarëve të Serbisë, Ministria e kulturës së Republikës së Serbisë ka organizuar pjesëmarrjen e ansambllit „Kolo” në Bujanoc dhe Medvegjë. Ansambli folklorik „Kolo” për herë të parë në Shtëpinë e kulturës „Vuk Karaxhiq” në Bujanoc ka mbajtur koncert. Në këtë koncert janë paraqitur ansamblet Serbe dhe Shqipe. Këtë koncert e ka shpallur të hapur ministri i kulturës Nebojsa Bradiq.

- **„Vizita e ministrit të kulturës Nebojsa Bradiq në Bujanoc** – Ministri Bradiq me rastin e nikoqirlëkut të SHKA



„Kolo” në Bujanoc e vizitoi edhe lokalitetin arkeologjik „Kalaja” në fshatin Krshevicë dhe bisedoi me kryetarin e komunës së Bujanocit e njëherit edhe zëvendëskryetar i Trupit Koordinues për Serbinë jugore Shaip Kamberin. Ministri Bradiq me atë rast ka deklaruar se ministria e tij do të ndihmojë projektin e multikulturalitetit në jug të Serbisë e posaqërisht medijat në gjuhën shqipe dhe serbe. Ministri Bradiq në Press Qendrën e Trupit Koordinues në Bujanoc ka biseduar me përfaqësuesit e mediave të Serbisë jugore. Rreth problemeve të mediave dhe gazetarëve ka folur Nadezhda Gaqe, kryetarje e gazetarëve të pamvarur të Serbisë (NUNS) e cila mes tjerash tha se, kjo shoqatë ka inicuar Fondin për

- **Petar Pan në Bujanoc dhe Preshevë** – Pas gati se një dekadë, voglushët në Bujanoc dhe Preshevë patën rastin që gjatë muajit prill të shoqërohen me anëtarët e „Trupa nga Prapaskena” e cila çfaqti pjesën teatrale „Avanturat e Petar Panit”. Ardha e teatrit Novosadas është organizuar nën përkujdesjen e Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ndërsa hyrja për fëmijë dhe mësuesit e tyre ka qenë falas. Çfaqjen në këto dy qytete e kanë përcjellur 750 nxënës të ciklit të ulët të shkollave fillore.



- **„Peqa dhe ujku” në Bujanoc dhe Medvegjë** – Pas pranimit të shkëlqyeshëm të „Petar Panit” si njëres prej çfaqjeve të parë për fëmijë të çfaqur pas shumë vitesh në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, me qëllim përforcimit të ngjarjeve kulturore dhe arsimore për më të vegjëlit, më 11 qershorë në Bujanoc dhe Medvegjë ka organizuar egzekutimin e çfaqjes „Peqa dhe Ujku” në ekzekutim të kuintetit frymorë të filharmonisë nga Beogradi e cila sipas fjalëve të tyre është pranuar në mënyrë fenomenale.

- **„Ditët e ombudspersonit” në jug të Serbisë** – Mbrojtësi i qytetarëve të Serbisë (Ombudspersoni republikan) Sasha Janković me bashkëpunëtorët e tij ka vizituar Bujanocin, Preshevën dhe Medvegjën më 26 dhe 27 maj



ku me këtë rast bisedoi me qytetarët dhe përfaqësuesit e mediave lokale rreth problemeve të të drejtave të qytetarëve. Ombudspersoni me kryetarin e Trupit Koordinues Milan Marković dhe udhëheqësit e këtyre tri komunave më 26 maj në Bujanoc bisedoi rreth hapjes së zyrës së ombudspersonit në jug të Serbisë. Gjatë „Ditës së ombudspersonit” në jug të Serbisë, mbrojtësi i qytetarëve dhe bashkëpunëtorët e tij vizituan shkollat, qendrën për punë sociale, stacionet policore si dhe institucione tjera publike. Milan Marković, kryetari i Trupit Koordinues theksoi se për raportet në Serbinë e jugut është me rëndësi të veçantë faktin se „Zyrja e parë e mbrojtësit të qytetarëve jashtë Beogradit do të hapet në këto tri komuna në Serbinë jugore”. Zyrja e ombudspersonit republikan do të hapet në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë deri në fund të këtij viti dhe është shpallur konkurs për përfaqësuesit e Mbrojtësit të qytetarëve në këto tri komuna në <http://www.ombudsman.rs/attachments/konkurs.doc>

- **Grupi punues për arsim, kulturë, informim, sport dhe rini** – Grupi punues është formuar në prill të vitit 2009, ndërsa udhëheqës i grupit është sekretarësja shtetërore pran ministrisë për arsim Tinde Kovač-Cerović. Grupi punues për arsim, kulturë, informim, sport dhe rini ka mbajtur katër takime. Ky grup përqipet që në mënyrë operative t’i zgjidhë problemet nga sfera e arsimit dhe kulturës kurse shumica e prioriteteve do të definohen përmes Këshillit nacional të pakicave kombëtare. Grupi punues është marrë vesh që ministria për arsim do të investoj mjetet shtesë për blerjen e kompjuterëve dhe të pajisjeve tjera për shkollat në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Janë pajtuar edhe për organizimin e dhënies së provimit profesional për punëtorët arsimor nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, ndërsa rrethi i parë i provimit është mbajtur në muajin tetorë, ndërsa rrethi i dytë do të mbahet në shkurt dhe mars të vitit 2010. Është paraparë që në Bujanoc të hapet zyra për mbikqyrje profesionale-pedagogjike, ndërkaq konkursi për këtë vend pune do të shpallet deri në fund të tetorit të vitit 2009. Ministria e arsimit është e pajtimit për hapjen e paraleles në gjuhën shqipe për fëmijët me aftësi të kufizuara nga Bujanoci. Është diskutuar edhe për çështjen e teksteve shkollore dhe planëprogramit mësimorë në gjuhën shqipe si dhe për problemin e numrit të pakët të të punësuarëve në shkollat e Preshevës. Ministria e kulturës dhe Ministria për rini dhe sport janë pajtuar që anëtarët e grupit punues t’i paraqesin propozim kërkesat për projektet dhe se për ato propozime do të bisedohet në takimin e radhës së grupit punues.

Trupi Koordinues është në kontakt të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtar të cilët janë të interesuar për gjendjen në jug të Serbisë me qëllim të përmirësimit të jetesës në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Sukseset më të mëdha në periudhën e kaluar:

- **Bashkëpunimi me Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE)** – Misioni i OSBE-së në Serbi i ka ofruar përkrahje të plotë punës së Trupit koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë. Përkrahja më e rëndësishme gjithsesi se ka të bëjë me ndihmën profesionale ma rastin e hartimit të studimit të fizibilitetit për hapjen e fakulteteve në Bujanoc dhe Preshevë, që është e domosdoshëm për analizimin e të gjitha aspekteve me rëndësi për hapjen e këtyre institucioneve të larta shkollore në Preshevë dhe në Bujanoc gjatë viteve 2010 dhe 2011. Përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në cilësinë e njëjës prej palëve nënshkruese të Marrëveshjes mbi parimet e rekonstruimit të Trupit koordinues, gjithashtu marrin pjesë edhe në takimet e kryesisë së Trupit koordinues.
- **Bashkëpunimi me Agjencionin amerikan për zhvillim ndërkombëtar (USAID), për hapjen e fakultetit në Medvegjë** – Trupi koordinues e thekson bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë bashkëpunimit me rastin e implementimit të programit për planifikim dhe reagim në situata të jashtëzakonshme dhe të forcimit të sigurisë ekonomike, të cilën e financon kjo organizatë donatore. Ky program financiarisht ka përkrahur përkthimin në gjuhën shqipe të teksteve universitare të Fakultetit Juridik dhe Ekonomik të Universitetit të Nishit.

- **Projekte te reja në jug të Serbisë** – Kontratat mbi realizimin projekteve “Forcimi i kapaciteteve për zhvillim lokal inkluziv në jug të Serbisë” dhe “Promovimi i paqes së qëndrueshme në jug të Serbisë” në Qeverinë e Serbisë



i kanë nënshkruar kryetari i Trupit koordinues, Millan Marković dhe bashkëpunëtori i përhershëm i Ekspicit të Kombeve të bashkuara në Serbi, Viliam Infante. “Në këtë projekt janë investuar 7.920.000 dollarë amerikan, ndërsa do të zbatohet në 13 qytete dhe komuna të Qarkut të Pčinjës dhe të Jabllanicës. Këto janë ato vende të cilat më së shumti kanë nevojë për ndihma”, theksoi Marković. Ai theksoi se projektet do të realizohen në Vranjë, Tërgovishtë, Bosilegrad, Vlladiçin Han, Surdulicë, Bojnik, Medvegjë, Leskoc, Lebanë, Vllasotincë, Cërna Travë, Preshevë dhe në

Bujanoc. Vilijam Infante, Drejtori i zyrës së UNDP-ës për Serbi, ka shprehur bindjen se këto dy projekte do t’i kontribuojnë forcimit të paqes në jug të Serbisë. “Së bashku me qeverisjet lokale në jug të Serbisë, do të punojmë ashtu që institucionet t’i afrohen secilit dhe të avancohet puna e tyre. Ashtu do të krijohen parakushtet për zhvillim ekonomik dhe të përmirësojmë kualitetin jetës së qytetarëve”, theksoi Infante. Projekti “Forcimi i kapaciteteve për zhvillim lokal inkluziv në jug të Serbisë” do të zgjasë tri vite, ndërsa mjetet në shumë prej 5.420.000 dollarë amerikan i kanë siguruar Agjensioni i Suedisë për zhvillim ekonomik ndërkombëtar, Agjensioni Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim, Qeveria Norvegjeze dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillim (UNDP). Projekti “Promovimi i paqes së qëndrueshme në jug të Serbisë” do të zgjasë 2.5 vite, ndërsa për realizimin e tij mjetet në shumë prej 2.5 milion dollarë janë siguruar nga Fondi për zhvillimin e qëllimeve të mijëvjeçarit të Qeverisë Spanjolle. Donatorët nga Zvicra, Suedia dhe Spanja kanë paralajmëruar se do të vazhdojnë ta ndihmojnë Serbinë në forcimin e kapaciteteve të vetadministratave lokale dhe që ato të jenë sa më afër qytetarit.

Në komunikim me publikun



Trupi Koordinues e publikon për opinion raportin e vet të katër. Raporti ka për qëllim informimin qytetarëve të Serbisë për punën e Trupit koordinues, si dhe për komunikimin me Ministrinë dhe Agjensionet të Qeverisë së Serbisë dhe me partnerët ndërkombëtar. Trupi Koordinues raportin e dërgon në mbi 400 adresa të partnerëve lokal dhe ndërkombëtar, ndërsa gjendet edhe në faqen elektronike të Trupit koordinues www.kt.gov.rs.

Qëllimi i Trupit koordinues është që përmes partneritetit me ministrinë e tjera qeveritare të Republikës së Serbisë, me organizatat ndërkombëtare dhe me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare t’i kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunave

Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Trupi koordinues përpaket t’i përparojë kapacitetet e pushteteve lokale dhe të shoqërisë civile, ashtu që vetë të mund të kujdesen për zhvillimin vetanak, pa u mbështetur në ndihmat emergjente me të cilat nuk ka përmirësim të situatës në shtigje afatgjate, që nuk është e qëndrueshme dhe nuk i kontribuon uljes së varfërisë të këtyre komunave

Republika e Serbisë Trupi Koordinues për komunat
Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë

Tel: 011 21 20 906
011 21 20 907
Faks: 011 21 20 909

E-mail: office@kt.gov.rs